



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE**

Nr. Prot. \_\_\_\_/\_\_\_\_

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: SUPERVIZIM PER NDERTIMIN E GODINES SE RE TE BACK  
UP-VLORE**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mbikeqyrja e  
punës së ndertimit-71247000-1**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1,253,894 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e  
tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor -QKUM- ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Neni 82 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të procedurës që prokurohet**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me **vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit që prokurohet**, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.

- Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata dhe vërtetimi për realizimin me sukses të saj ose kontrata dhe faturat tatimore të shitjes.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Faturat duhet** të jenë të deklaruara në organet tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për mbikqyrje të shoqërisë, si vijon:

### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

• **NP – 1 A (Punime germimi në tokë)**

*Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në vëllim të tokës, të realizuara me çfarëdo lloji mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore*

• **NP – 2B (Ndërtime civile e industriale)**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

**NP – 7 A (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.)**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

### **PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

**NS-2A (Impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)**

*Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës*

**NS - 3 A (Impiante ngritëse dhe transportuese)**

*Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë,*

*shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

***NS-4 B(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)***

*Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymëve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme*

***N.S - 12 A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit);***

*Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.*

***• NS-14B (Impjante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV)***

*Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike radiotelefonit e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme*

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk koresponдон me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës.*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në V.K.M nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Licencat e mesiperme janë të njëjta me licencat e objektit të prokurimit **Ndërtimi i godinës së re të Back Up per QKUM me fond limit 120,024,898.33 (njëqind e njëzet milion e njëzet e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë .33) lekë pa TVSH me REF-26050-10-23-2024**

AK-ja në përcaktimin e kategorive të licencës së kërkuar në këtë procedurë prokurimi merr në konsideratë Ligjin Nr. 8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pasi në përzgjedhjen e kategorive dhe klasave të licencës, licencat e mbikëqyrësit janë të njëjta me ato të ndërtuesit.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 (pesë) persona** për periudhën **shtator 2024**. Për këtë duhet të paraqesë:

- **Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore**, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën **shtator 2024**
- **Listepagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqerore**, Shendetesore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punesimi për **shtator 2024**.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 DST.**

**Argumentimi:** Referuar nenit 26, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontrakt pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të tre formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla” Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Konkretisht:

**2.3.4** Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, si drejtues teknik, personelin si me poshte:

- **një inxhinier ndërtimi,**
- **nje inxhinier mekanik**
- **nje inxhinier hidroteknik**
- **nje inxhinier elektrik ose inxhinier elektronik**

Inxhinierët e mësipërm duhet të jenë në licensën e kompanisë dhe të figurojnë në listë pagesat e punonjësve të shoqërisë. (Formularët E-Sig 025/a.1).

**Per kete OE te paraqese:**

- Licensat personale te vlefshme sipas VKM nr. 943, datë 28.12.2016
- CV-të e stafit
- Kontrata e punes e vlefshme

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 te Df**

**Shenim:** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formula përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, K dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

*Bazuar ne licencen e shoqerise si me lart(pika 2), kerkojme min tre drejtues teknik bazuar dhe ne V.K M nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Kreu IV neni 23/c) Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.*

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesmarres duhet te deklaroje (jo drejtues teknik) inxhinierin e ndertimit, qe do te jete ne kantier (ne rolin e drejtuesit te projektit nga ana e supervizorit):

**1 inxh.ndertimi me eksperience minimalisht 2 vite ne supervizim**

Per kete inxhinier, duhet te paraqiten kontrata e punes brenda afatit te vlefshmerise se ketij objekti, diploma dhe cv.

**Argumentimi:** bazuar ne UKM nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,pervec

*drejtuesve teknike qe duhen deklaruar, duhet qe per kete object investimi dhe inxhinieret jodrejtues teknike (te kantierit) qe do te ndjekin punimet dhe do te koordinoje punet midis sipermarresit dhe investitorit sipas grafikut te punimeve.*

**2.3.6.** Shoqërite ofertuese, duhet të prezantojnë se kanë në stafin e tyre ose te kontraktuar vetëm për këtë procedurë (ose drejtues Teknik, ose inxhinier jo drejtues Teknik,):

- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Per kete inxhinier, duhet te paraqiten kontrata e punes brenda afatit te vlefshmerise se ketij objekti, diploma, cv dhe licenca- **N.S - 18 Punime topogjeodezike**

**Argumentimi: i domosdoshem per kryerjen e rilevimit topografik, akt-piketimet, etj**

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:*

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për sherbimin e mbikqyrjes se punimeve te zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të sherbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për kryerjen e sherbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.*

**2.3.7** Shoqëria duhet te paraqesë Certifikatat e cilësisë si me poshtë:

- a. Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH EN ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **SSH EN ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatën **SSH EN ISO 45001:2018** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

**Argumentim:** Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne nenin 79, te Ligjit nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas te cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor per te vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë” si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**SSH EN ISO 9001** percakton nje sere kerkesash te cilat nje shoqeri duhet ti plotesoje per te pasur nje sistem menaxherial te cilesise, i cili te jete funksional dhe te marre certifikimin.

Ky kriter eshte i lidhur me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesemarres si dhe bazuar ne Vendimin e KPP 619/2014 pika III.2.1 , III.2.2 dhe III.2.3 lidhur me vendosjen e certifikimeve ISO ( bashkelidhur ketij proces verbali).

**SSH EN ISO 14001** percakton kerkesat per nje sistem te menaxhimit mjedisor dhe mund te zbatohet dhe certifikohet cdo kompani, pavaresisht nga madhesia, aktiviteti ose ndikimi i tij ne mjedisin rrethues.

**SSH EN ISO 45001** standarti i njohur qe eshte publikuar ndonjehere ne nivel nderkombetar. Ai percakton kerkesat per nje sistem menaxherial te shendetit dhe sigurise ne pune edhe mund te implementohet dhe te certifikohet nga cdo shoqeri, pavarsisht dimensioneve, struktures apo fushes se aktivitetit. Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ndihmon në identifikimin e rreziqeve, vlerësimin dhe mbajtjet nën kontroll të risqeve që vijnë si rezultat i aktiviteteve të shoqërisë si në kushtet e veprimeve normale ashtu edhe në kushte jonormale.

**Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.” Gjthashtu sjellim ne vemendje se:**

- Disponimi i kapaciteteve sipas **pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6 të kapacitetit teknik**, do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 10) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.



- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**SHENIM:**

Gjatë hartimit të ofertave dhe vlerësimit të tyre duhet të respektohet Rekomandimi i APP –së Nr. 5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.Kreu III – ndertesa dhe ndarje funksionale, grupi IV tarifor dhe Faza VIII dhe Faza IX e tabelës 5 bazuar në nenin 24 të VKM nr.354.

\*\*\*

**Vendi i kryrjes së shërbimit dhe afatet e ekzekutimit:**

<b>Shërbimet</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>
	<b>“Supervizimi për ndërtimin e godinës së re të back up të QKUM”</b>	<b>1,253,894</b> (një milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH,	<i>Vlorë</i>	<b>18(tetëmbëdhjetë) muaj</b> nga njoftimi për fillimin e punimeve (sipas grafikut të punimeve të dhënë nga projektuesi)

**Specifikimet teknike/Termet e references:**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Supervizimi për ndërtimin e godinës së re të Back Up QKUM ne Vlore”

Detyrat: **1. Objektivi kryesor i Mbikqyrësit**

1.1 Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

**2. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyrësit**

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

1. Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit përgjegjës dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislacionit në fuqi. (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 2, datë 13.05.2005) si dhe VKM nr.610 datë 22.09.2022 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësive profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”*

**Detyrat dhe përgjegjësitë e mbikqyrësit janë të përcaktuara qartë në VKM nr.610 datë 22.09.2022 – Kreu II dhe Kreu IV**

1. Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.
2. Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.
3. Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.
4. Mbikëqyrësi i punimeve para fillimit të punimeve bën verifikimin paraprak, që konsiston në:

- a) Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
- b) Verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet;
- c) Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe të të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate;
- d) Marrjen në dorëzim të punës dhe të furnizimeve të materialeve nga zbatuesi i punimeve, duke mbajtur një procesverbal për rezultatin e marrjes në dorëzim;
- e) Verifikimin, vendosjen e tabelës së identifikimit në kantier me të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimi i objektit;
- Data e marrjes së lejes së ndërtimit;
- Zhvilluesi;
- Projektuesi;
- Zbatuesi i punimeve dhe drejtuesi teknik;
- Mbikëqyrësi;
- Afati i ndërtimit;
- Sipërfaqja e ndërtimit;
- Lartësia (numri i kateve mbi dhe nën tokë).

5. Mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi, për çdo objekt që ndërtohet, administrojnë në kantier dokumentacionin teknik dhe mbajnë përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, si:

- ✓ Lejen e zhvillimit, lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi kompetent, si dhe me planvendosjen;
- ✓ Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas shtojcës i bashkëlidhet këtij vendimi;
- ✓ Projektin e zbatimit, të miratuar nga organi, i cili ka këtë të drejtë, sipas juridiksionit dhe oponencën teknike;
- ✓ Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve, të hartuara nga projektuesit;
- ✓ Studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;
- ✓ Studimin sizmik;
- ✓ Planorganizimin e punimeve të ndërtimit, i cili përmban planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, grafikun e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimit për ndërtimin e objektit sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës;
- ✓ Aktin e miratimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, miratuar nga organi kompetent;
- ✓ Ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre, si dhe dokumentacionin ku

- pasqyrohen të gjitha problemet e verifikuara, të miratuara dhe të firmosura nga ai;
- ✓ Çertifikatën profesionale (licencat) të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit;
  - ✓ Njoftimin për fillimin e punimeve, sipas shtojcës VI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Procesverbalin mbi fillimin e punimeve në objekt, sipas shtojcës X, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Aktin e piketimit të objektit, sipas shtojcës IX, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Aktkontrollin e kuotës + 0.00, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Aktet e miratimit në fushën e trashëgimisë kulturore, arkeologjike apo zonat e mbrojtura mjedisore, sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
  - ✓ Librezën e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e punimeve, sipas shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit;
  - ✓ Situacionet mujore pjesore dhe progresive, të hartuara mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, sipas shtojcës XII, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Librin e kantierit;
  - ✓ Ditarin e objektit, sipas shtojcës V, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Pasqyrën e realizimit të punimeve, sipas shtojcës XI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Procesverbalet e punimeve të maskuara, sipas shtojcave VII dhe VIII, që i bashkëlidhen këtij vendimi;
  - ✓ Provat dhe çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura në objekt;
  - ✓ Aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit;
  - ✓ Deklaratën teknike të zbatuesit të punimeve, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Aktin e kolaudimit të fazës së karabinasë;
  - ✓ Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe paisjen me mjete mbrojtëse përkatëse;
  - ✓ Aktet e inspektimit të kryera gjatë zbatimit të punimeve, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  - ✓ Dokumentin e vlerësimit të rrezikut, që hartohet për një kantier të veçantë, sipas vendimit

nr.312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, i quajtur Plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK);

- ✓ Siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt;
- ✓ Siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike;
- ✓ Policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale;
- ✓ Dokumentacionin fotografik apo videoregjistrimin për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, punimet e maskuara;
- ✓ Projektin e zbatuar;
- ✓ Projektin për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;
- ✓ Çertifikimi i montimit të ashensorëve dhe inspektimit final;
- ✓ Taportimet 45 ditore të bëra pranë Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe autoritetit të lëshimit të lejes së ndërtim

6. Mbikëqyrësi i punimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim nga zbatuesi i punimeve për përfundimin e punimeve, nëse nuk i vihet në dispozicion, i kërkon zbatuesit të punimeve dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- Kontratën dhe aktet që lidhen me të;
- Regjistrimin e kontabilitetit;
- Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve;
- Çertifikatat e cilësisë të provave të materialeve të përdorura gjatë procesit të ndërtimit, të lëshuara nga laboratorët e akredituar për këtë qëllim;
- Për materiale të importuara, çertifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Evropian;
- Deklaratën që vërteton se objekti është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, si dhe në përputhje me kushtet teknike në fuqi, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- Deklaratën që vërteton se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara, nëse ka pasur.

### Sqarim

Përlllogaritja e fondit limit është bërë bazuar në **VKM nr.354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e**

*manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”,*

*Kreu III Planifikimi i Objekteve; seksioni I – Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre, duke marrë në përlllogaritje Grupin IV tarifor:*

- a. **Kreun III – Planifikimi i objekteve; SEKSIONI I – NDËRTESTAT DHE NDARJET FUNKSIONALE, ku do te marrim ne shqyrtim fazat 8 dhe faza 9**

<b>Nr.</b>	<b>Fazat</b>	<b>Përqindja e tarifës</b>
		<b>për ndërtesa</b>
1	Analiza e det se projekt/percaktimi i baze se projektit	3%
2	Projekt ideja paraprake	7%
3	Projekt ideja perfundimtare	11%
4	Projekti per miratimin e lejes se ndertimit	6%
5	Projekt zbatimi	32%
6	Preventivi perfundimtar	10%
7	Organizimi i procedures dhe vleresimi i tenderit	3%
<b>8</b>	<b>Mbikqyrja</b>	<b>25%</b>
<b>9</b>	<b>Pergatitje e dokumentacionit perfundimtar per kolaudim</b>	<b>3%</b>

**NJESIA E PROKURIMIT**